



**Labour Market Activation of vulnerable groups**  
**This project is funded by the European Union**



“Aktivizim i grupeve të lëndueshme në tregun e punës” është projekt i financuar nga Unioni Evropian. Qëllimi i këtij IPA Projekti është përfshirje efektive i personave të lëndueshëm dhe të pranuesve të ndihmës sociale në tregun e punës dhe arritje e rezultateve më të mira të mundshme për ata përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të personalizuar dhe zhvillim të shkathtësive. Projekti i përkrah masat vijuese aktive në tregun e punës: Program për përkrahje psiko-sociale dhe për përkrahje mentorimi; Trajnime për shkathtësi të kërkuara në tregun e punës; Trajnime në vendin e punës dhe Punësim i subvencionuar. Gjuha zyrtare e Projektit do të jetë gjuha angleze.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 5 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik dhe Kontratën për IPA Projektin ku janë t[ definuara pozicionet punuese, kriteret për zgjedhje dhe mjetet e siguruara financiare, Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon:

### **SHPALLJE PUBLIKE**

**për punë për kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 32 muajve, me orar të plotë pune**

I. Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka nevojë për themelimin e marrëdhënies së punës me gjithsej 1 (nje) kryerës në njësinë projektuese për implementimin e IPA dhe projekte të tjera të financuara nga ndihma e huaj, për kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 32 muaj, për vendet vijuese të punës:

#### **KONTABILIST - 1 (një) ekzekutues**

Kontabilisti do të përgjigjet për të gjitha aspektet e kontabilitetit dhe për pagesat nga Marrëveshja për grant; siguron që të gjitha transaksionet nga Marrëveshja të evidentohen me vërtetime financiare; i përgatit dhe i dërgon për kontroll dhe miratim te Menaxheri i Projektit të gjitha raportet financiare, ruan dhe siguron evidenca të rregullta kontabiliste, vërtetime financiare, buxhete, projeksione financiare, projeksione për shpenzimet në para dhe të gjitha raportet e tjera të kërkuara nga organi kontraktues; do të ketë bashkëpunim të afërt me Nëpunësin për furnizime për tu siguruar se të gjitha aspektet e kontabilitetit, furnizimeve dhe pagesave janë të bëra në mënyrë të rregullt dhe në kohë, të gjitha burimet e financimit të jenë në dispozicion për nevojat e Projektit dhe të



**Labour Market Activation of vulnerable groups**  
**This project is funded by the European Union**



sistemit për ndjekje të pagesave nga Marrëveshja të jetë funksional; kontrollon fatura hyrëse dhe përgatit dokumente për pagesë; arkivon dokumente financiare të projektit; siguron përkrahje dhe bashkëpunon me ekipin e projektit e ngjashëm.

Neto rroga për vendin e punës është 31.344 denarë.

Kandidatët **për vendin e punës**, duhet ti përmbushin kushtet vijuese:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të përfituar nivel të kualifikimit VI-A sipas kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe më së paku 240 kredi të përfituara sipas EKTS ose të kenë kryer shkallë VII/1;
- të kenë shkathtësi të shkëlqyera komunikimi të të folurit dhe të shkruarit të gjuhës maqedonase dhe anglishte ;
- të kenë patent shoferi të kategorisë B;
- të kenë njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- të kenë minimum 30 muaj përvojë pune në projekte/programe të financuara nga Unioni Evropian, nga të cilat 12 muaj përvojë si kontabilist ose nëpunës financiar në kuadër të projekteve Evropiane.

**II.** Marrëdhënia e punës lidhet me orar të plotë pune – 40 orë në javë nga e hëna deri të premten, nga ora 07:30 deri në orën 15:30.

**III.** Thirren të gjithë kandidatët e interesuar që ti dërgojnë Europass biografite të tyre të punës - CV (<http://europass.cedefop.europa.eu>) dhe letrat e motivimit në gjuhën anglishte, si dhe kopje të dokumenteve me të cilat konfirmohet se i përmbushin kushtet e kërkuara në shpalljen (shtetësi, diplomë, kontrata/referenca nga punëdhënës paraprak, patet shoferi), në një zarf të mbyllur përmes postës ose në dorë, në adresën vijuese: Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shërbimi Qendror, rr. Vasil Gjorgov nr. 43, 1000 Shkup.

Në anën e jashtme të zarfit është e obligueshme të theksohet titulli i projektit dhe pozicioni për të cilin aplikon kandidati, me vërejtjen “të mos hapet deri në sesionin për evaluim”.



**Labour Market Activation of vulnerable groups**  
**This project is funded by the European Union**



**IV.** Afati për paraqitje **data përfundimtare për aplikime është 31.01.2020, deri në orën 15:30.** Ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitje.

**Vërejte:** Nuk do të shqyrtohen aplikimet të cilat nuk janë të dërguara në pajtim me pikat III dhe IV të kësaj shpalljeje. Ju lutemi pa paraqitje përmes telefonit.

**V.** Vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në rrethin më të ngushtë do të informohen dhe do të ftohen për intervistë.

Pyetjet e tërthorta (mundësi të barabarta, përkatësi etnike e ngjashëm) do të merren parasysh në të gjitha aspektet e procesit të punësimit. Kjo shpallje është e publikuar edhe në ueb-faqen e APRMV -<http://av.gov.mk>.